



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 13293 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

URDHËR

Nr. 671, datë 29.12 2017

PËR

**SHPALLJEN E KONKURISIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA DHE/OSE
PËRMBAJTJEVE DIGJITALE PËR KLASËN E DYMBËDHJETË TË ARSIMIT TË
MESËM TË LARTË, VITI SHKOLLOR 2018 - 2019**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 47 të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.02.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Shpalljen e konkursit për tekstet shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale të klasës së dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë, për vitin shkollor 2018 - 2019, si më poshtë:

- 1.1 Gjuha shqipe 12
- 1.2 Letërsia 12
- 1.3 Matematika 12
- 1.4 Ekonomia 12

- 1.5 Letërsia me zgjedhje 12
- 1.6 Matematika me zgjedhje 12
- 1.7 Fizika me zgjedhje 12
- 1.8 Biologjia me zgjedhje 12
- 1.9 Kimia me zgjedhje 12
- 1.10 Historia me zgjedhje 12
- 1.11 Gjeografia me zgjedhje 12
- 1.12 Psikologjia me zgjedhje 12
- 1.13 Sociologjia me zgjedhje 12
- 1.14 Teknologjia me zgjedhje 12
- 1.15 TIK me zgjedhje 12
- 1.16 Gjuha angleze e parë 12
- 1.17 Gjuha angleze e dytë 12
- 1.18 Gjuha frënge e parë 12
- 1.19 Gjuha frënge e dytë 12
- 1.20 Gjuha italiane e parë 12
- 1.21 Gjuha italiane e dytë 12
- 1.22 Gjuha gjermane e parë 12
- 1.23 Gjuha gjermane e dytë 12

2. Datat e aktiviteteve për konkursin e teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale të klasës së dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë, janë:

- | | |
|--|----------------------|
| a. Shpallja e konkursit | dhjetor 2017 |
| b. Dorëzimi i teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale për vlerësim | 08 dhe 09 maj 2018 |
| c. Shpallja e fituesve | 24 maj 2018 |
| d. Përzgjedhja e teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale dhe porosia të botuesit | 12 - 17 qershor 2018 |
| e. Shitja e teksteve dhe/ose përmbajtjeve digjitale | gusht - shtator 2018 |

3. Hartimi i teksteve shkollore të reja dhe/ose përmbajtjeve digjitale të klasës së dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë të bëhet në përputhje me programet mësimore dhe në respektim të standardeve të teksteve shkollore, të miratuara nga MASR.

- a) Tekstet shkollore të reja dhe/ose përmbajtjet digjitale “Matematika 12”, “Matematika me zgjedhje 12”, “Fizika me zgjedhje 12”, “Biologjia me zgjedhje 12” dhe “Kimia me zgjedhje 12”, bazuar në plotësimin e kritereve mbi përshtatshmërinë e programeve tona me tekstet e huaja, të jenë përkthim i teksteve shkollore të shtëpive botuese “Oxford University Press”, “Pearson” dhe “Cambridge”. Kjo të dokumentohet me kontratën paraprake të lidhur mes subjekteve. Me lejen paraprake përkatëse nga botuesi i huaj, përkthimet mund të përshtaten në realitetin shqiptar për elementet që i përkasin realitetit të huaj. Formatu fizik i librit të nxënësit dhe fletores së punës duhet të jenë të njëjta me ato të origjinaleve (për fletoren e punës vetëm në rastin kur ajo është fizikisht e ndarë nga libri i nxënësit dhe është pjesë plotësuese e tij). Fitues mund të shpallet edhe më shumë se një alternativë e secilit prej botuesve “Oxford University Press”, “Pearson” dhe “Cambridge”, por me kusht që ato të jenë me autorësi të ndryshme
Në konkurs duhet të paraqiten detyrimisht në 1 (një) kopje, tekstet origjinale përkatëse.
- b) Tekstet shkollore dhe/ose përmbajtjet digjitale të gjuhëve të huaja (Gjuha angleze e parë dhe e dytë 12; Gjuha frënge e parë dhe e dytë 12; Gjuha italiane e parë dhe e dytë 12 dhe Gjuha gjermane e parë dhe e dytë 12) të paraqiten në versionin e tyre origjinal, botim i shtëpive botuese të huaja, përkatësisht angleze, franceze, italiane dhe gjermane.
- c) Për secilin prej titujve të përfshirë në këtë urdhër, çdo botues, vendas ose i huaj, dhe çdo distributor i gjuhëve të huaja, ka të drejtë të konkurrojë vetëm me një alternativë.
- d) Teksti shkollor dhe/ose përmbajtja digjitale që paraqitet për konkurs, të përputhet me kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës dhe standardet e teksteve shkollore.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

